



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 2268141; 2268142

Nr. 99/4 Prot.

Tiranë, më 11.07.2017

**V E N D I M**

Nr. 155, datë 11/07/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 85, datë 21.07.2016 dhe ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Bashkisë Libohovë, prej datës 27.04.2016 e në vazhdim"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 85, datë 21.07.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 335 prot., datë 18.04.2016", në institucionin, Bashkia Libohovë,

**VËREJ SE:**

Me Urdhrin Nr. 335 prot., datë 18.04.2016, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes në Bashkinë Libohovë. Ky proces është përmyllur me Vendimin Nr. 85, datë 21.07.2016, "Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 335 prot., datë 18.04.2016", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

- 1. Fillimisht, njësia përgjegjëse, të përcaktojë pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil në bashki dhe në njësitë administrative në varësi të saj, duke u bazuar në funksionet dhe detyrat konkrete të vendeve të punës përkatëse të përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, nëse këto pozicione pune ushtrojnë funksione publike, duke përjashtuar rastet e përcaktuara në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Ky proces të materializohet në strukturën e miratuar nga Kryetari i institucionit me aktin administrativ nr. 14, datë 29.01.2016, i ndryshuar, duke u specifikuar në mënyrë të shprehur "Pozicion pune në shërbimin civil".*
- 2. Njësia përgjegjëse të kryejë verifikimin e marrëdhënieve të punës të personelit ekzistues të Bashkisë Libohovë dhe të Njësisë Administrative Zagorie, që kanë qenë të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit*

nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (data 26.02.2014). Në këtë verifikim të përfshihen edhe 2 rastet e punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil që në vitin 2011. Për kryerjen e verifikimit njësia përgjegjëse të tregojë kujdes duke vepruar në këtë mënyrë:

- a) Të plotësojë dosjen e personelit (dosjen individuale), të punonjësve, me të gjitha aktet e kërkuara sipas përcaktimeve të Vendimit Nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".
  - b) Të deklarojë statusin e punësimit, duke pasur parasysh faktin që kanë filluar punë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (data 26.02.2014), që i plotësojnë kushtet për të qenë nëpunës civil, sipas përcaktimeve të nenin 67, të ligjit në fjalë, si dhe që plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë.
3. Në rastin e punonjësit, i cili nuk plotëson kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të bashkisë, të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, duke drejtuar procesin për të revokuar pikën 19, të urdhrit nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë, që emëron punonjësin \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialist i Tatim-Taksave", emëruar fillimisht në pozicion pune pjesë e shërbimit civil që në vitin 2002.
4. Njësia përgjegjëse, të revokojë aktet administrative, të cilët kanë dalë në kundërshtim me ligjin, për emërimin e përkohshëm të 7 punonjësve, si më poshtë:
1. Të revokojë pikën 5, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar";
  2. Të revokojë pikën 6, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialist në Sektorin e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar";
  3. Të revokojë pikën 16, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin "Shef i Sektorit të Shërbimit Urban";
  4. Të revokojë pikën 12, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialist Juridik dhe Integrimi në BE";
  5. Të revokojë pikën 21, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialist i Tatim-Taksave";
  6. Të revokojë pikën 20, të aktit administrativ kolektiv nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin "Specialist i Tatim-Taksave";
  7. Të revokojë aktin administrativ nr. 16, datë 02.03.2015, të Kryetarit të Bashkisë Libohovë, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* në detyrën "Koordinatorë për të Drejtën e Informimit".
5. Njësia përgjegjëse duhet të ndryshojë aktin administrativ nr. 22, datë 26.02.2016, për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2016, duke shtuar e konsideruar si vende vakante dhe pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil të plotësuar në kundërshtim me ligjin dhe ta publikojë atë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqet e

tyre zyrtare dhe në stendat për njoftime publike të institucionit sipas përcaktimeve në Vendimin Nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”.

Njësia përgjegjëse, në bazë të këtij plani duhet të zhvillojë procedurat e konkurrimit, për pozicionet që do të mbeten të lira, zbatimi i të cilit do të ndiqet nga përfaqësuesit e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

6. Njësia përgjegjëse, të plotësojë pozicionet e punës që mbeten të lira, me anën e procedurave të konkurrimit të hapur sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dalë për zbatim të tij, apo nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, si procedura që përfaqësojnë sistemin e karrierës në shërbimin civil.

Njësia përgjegjëse gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, të kujdeset të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “Pranimi në shërbim civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike. Në veçanti, njësia përgjegjëse të kujdeset për të respektuar kërkesat ligjore në procedurat si më poshtë:

- a) Të krijohen Komisionet përkatëse të pranimi dhe vlerësimit (Komiteti i Përherëshëm i Pranimi për nivelin ekzekutiv, Komiteti për Lëvizjen Paralele dhe Ngritjen në Detyrë) sipas procedurës që do të ndjekë për të plotësuar pozicionet e punës pjesë të shërbimit civil. Komisioni i vlerësimit ka për detyrë të kryejë vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në konkurrim, i cili konsiston në vlerësimin e jetëshkrimit, vlerësimin me shkrim (përveç lëvizjes paralele) dhe vlerësimin në intervistën e strukturuar me gojë.
- b) Të bëjë publike në faqen zyrtare, “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe faqen zyrtare të Bashkisë Libohovë, ose nëse është e mundur, në stendat për publikun, shpalljet si:

- Aktin e shpalljes për të plotësuar një pozicion të lirë pune në shërbimin civil. Të tregohet kujdes që ky akt të përmbajë të dhënat e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreu III, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si: përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; pranim në shërbim civil; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimi (arsimi i lartë përkatës); dokumentacionin që do të paraqitet, mënyrën dhe procedurën e paraqitjes së kandidaturave; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrimin kombëtar; mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me aplikantët dhe elementë të tjerë ligjorë që duhet të përmbajë shpallja.

- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.

- Aktin e shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht (lista përfundimtare) për të dy fazat e konkurrimit, si për fazën e parë “lëvizja paralele”, ashtu edhe për fazën e dytë “pranim në kategorinë ekzekutive ose ngritje në detyrë”.
- Aktin e shpalljes së kandidatit të nxjerrë fitues me më shumë se 70% të pikëve nga Komisioni përkatës.

7. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, të zbatojë vendimin brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni dhe pas këtij afati të dërgojë pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, një informacion të detajuar bashkë me aktet përkatëse, që materializojnë veprimet administrative përkatëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 85, datë 21.07.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Libohovë, prej datës 27.04.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin Nr.21, datë 10.02.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 85, datë 21.07.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Bashkia Libohovë, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 27.04.2016 e në vazhdim”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 85, datë 21.07.2016, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 335 prot., datë 18.04.2016”.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Bashkisë Libohovë, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën Nr. 99/2 prot., datë 10.02.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt, në mungesë të Përgjegjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, kontaktoi me personin e caktuar nga Kryetari i Bashkisë Libohovë, në pozicionin Përgjegjës e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe verifikoi një pjesë të materialeve shkresore, të cilat vërtetohin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues. Pjesa tjetër e akteve janë dërguar me postë ashtu sikundër është përcaktuar në procesverbalin e mbajtur. Takimi me njësinë e burimeve njerëzore, si dhe verifikimi i akteve dhe dokumentacionit shoqërues që administrohej nga kjo zyrë është materializuar në procesverbalin e datës 15.02.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit pranë Bashkisë Libohovë në pozicionin Përgjegjës e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, në zbatim të pikës 1 të vendimit të Komisionerit, me Urdhrin Nr. 38, datë 01.07.2016, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21 datë 26.02.2016 të Kryetarit të Bashkisë Libohovë”, ka ndryshuar aktin administrativ nr.14, datë 29.01.2016, duke specifikuar në mënyrë të shprehur pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.
- Në zbatim të pikës 2 të vendimit të Komisionerit, në të cilën i ishte lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të verifikonte marrëdhëniet e punës të personelit ekzistues dhe të Njesisë Administrative Zagorie, që kanë qenë të punësuar në pozicione pune pjesë të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, përfshi edhe rastet e punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , rezultoi se pas

përfundimit të verifikimit, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e deklarimit të këtyre 2 punonjësve dhe i ka administruar ato në dosjen e personelit (dosjen individuale), konkretisht:

- Me aktin nr. prot., 738, datë 27.06.2016, \*\*\*\*\* është deklaruar “*nëpunës civil*”, në pozicionin e punës “*Veteriner*”;
  - Me aktin nr. prot., 737, datë 27.06.2016, \*\*\*\*\* është deklaruar “*nëpunës civil*”, në pozicionin e punës “*Specialist i bujqësisë*”.
- Në përfundim të verifikimit në subjekt, rezultoi se për zbatimin e pikës 3 të vendimit të Komisionerit, nuk janë marrë masa nga njësia përgjegjëse dhe kjo pikë rezultoi e pa zbatuar.
- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, në zbatim të pikës 4 të vendimit të Komisionerit, ka vepruar si më poshtë vijon:
- Pas shpalljes si të lirë të pozicionit të punës specialist finance, në përfundim të procedurës së konkurrimit, \*\*\*\*\* është shpallur fitues dhe është emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 41/1, datë 11.01.2017.
  - Pas shpalljes si të lirë të pozicionit të punës specialist finance, në përfundim të procedurës së konkurrimit, \*\*\*\*\* është shpallur fituese dhe është emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 41/2, datë 11.01.2017.
  - Pas shpalljes si të lirë të pozicionit të punës specialist i sektorit të zhvillimit urban, në përfundim të procedurës së konkurrimit, \*\*\*\*\* është shpallur fitues dhe është emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 941/1, datë 10.08.2016.
  - Me Urdhrin nr. 74, datë 10.08.2016, “*Për Revokimin e aktit administrativ nr. 22, datë 26.02.2016*”, është revokuar akti i emërimit për punonjësen \*\*\*\*\*;
  - Për punonjësin \*\*\*\*\*, nuk është bërë revokimi i aktit administrativ, i dalë në kundërshtim me ligjin, pasi ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë;
  - Me Urdhrin nr. 92, datë 06.10.2016, “*Transferim në detyrë*”, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar në detyrën e magazinierit të Bashkisë Libohovë pozicion ky jashtë shërbimit civil;
  - Akti administrativ nr. 16, datë 02.03.2016, për emërimin e punonjësës \*\*\*\*\* me detyrë “*Kordinatore për të Drejtën e Informimit*”, nuk është revokuar nga njësia përgjegjëse, pasi me shkresën nr. 1430/2 prot., datë 09.12.2016 “*Dërgim Informacioni*”, ky pozicion konsiderohet jashtë shërbimit civil.

Sa më sipër, rezultoi se në këto raste, situata e punonjësve ka ardhur brenda kornizave ligjore, pavarësisht se njësia përgjegjëse e Bashkisë Libohovë, nuk ka zbatuar me përpikmëri rekomandimet e Komisionerit në këtë pikë të Vendimit, gjë e cila duhet të mbahet parasysh që të mos përsëritet më në të ardhmen.

- Njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 5 të dispozitivit të Vendimit të Komisionerit ka shpallur si vende të lira, të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil të plotësuar në kundërshtim me ligjin, duke ndjekur të gjitha procedurat në përputhje me Vendimin Nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil*” (dokumentacioni i materializuar me shkresën nr. 1430/2 prot., datë 09.12.2016, “*Dërgim informacioni*”).
- Në zbatim të pikës 6, njësia përgjegjëse është kujdesur të përmbushë rregullat e përcaktuara në kreun IV “*Pranimi në shërbim civil*”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për*

*nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe Vendimin Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”.

- Në përputhje me pikën 6/a, me Urdhrin nr. 62, datë 28.06.2016, është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Nivelin Ekzekutiv për të gjitha vendet e lira në shërbimin civil;
- Në përputhje me pikën 6/b, janë bërë publikimet në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit (të cilat janë bërë pjesë e dosjes së verifikimit), dhe janë ndjekur procedurat si më poshtë:
  - ✓ është bërë shpallja e plotësimit të një vendi të lirë pune në shërbimin civil, i cili përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 8, të Kreut II, e pikën 5, Kreu III, të Vendimit Nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, si dhe të pikës 9, Kreu II, të pikës 4, Kreu VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave;
  - ✓ akti i shpalljes së kandidatëve të kualifikuar nga verifikimi paraprak;
  - ✓ akti i shpalljes së kandidatëve të kualifikuar përfundimisht;
  - ✓ akti i shpalljes së kandidatit fitues.

Për sa u përshtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 85, datë 21.07.2016, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 335 prot., datë 18.04.2016*”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Libohovë, janë zbatuar pjesërisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Bashkisë Libohovë, prej datës 27.04.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, nuk rezultoi asnjë akt administrativ emërimi i nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, për pozicione pune të shërbimit civil.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Konstatimin e rregullimit të pjesshëm të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Bashkisë Libohovë, duke zbatuar pjesërisht rekomandimet e Vendimit Nr. 85, datë 21.07.2016, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 335 prot., datë 18.04.2016*”.

2. Verifikimin e mëtejshëm të pikës 3 të dispozitivit të Vendimit Nr. 85, datë 21.07.2016, të Komisionerit, në të cilën është kërkuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të bashkisë, që të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor, duke drejtuar procesin për të revokuar pikën 19, të urdhrit nr. 22, datë 26.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë, që emëron punonjës in Arben Ismailati, në pozicionin “*Specialist i Tatim-Taksave*”.

Duke qenë se aktualisht ka hyrë në fuqi ligji nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, Kryetari i Bashkisë Libohovë, referuar nenit 113 të këtij ligji, duhet të anulojë pikën 19, të urdhrit nr. 22, datë 26.02.2016, duke nxjerrë një akt të ri me shkrim, brenda një afati 30-ditor nga marrja dijani.

3. Konstatimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative, të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Bashkisë Libohovë, prej datës 27.04.2016 e në vazhdim.
4. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Bashkisë Libohovë dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**